



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/18/23

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. Sh.B, në cilësinë e përfaqësuesit të palës paditëse L.SH, ndaj gjyqtares U.H, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 10.01.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. Sh.B në cilësinë e përfaqësuesit të palës paditëse L.SH, ndaj gjyqtares U.H, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Av. SH.B me datë 18 Dhjetor 2023 përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtares U.H, me kërkesë për inicim të procedurës disiplinore. Me datë 19.12.2023 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës.

Parashtruesi i ankesës av. SH.B në ankesën e tij ka deklaruar se me datë 17.09.2019 ka paraqitur padi për vërtetim pronësie në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër të paditurës V.XH, padi e cila është evidentuar me shenjë C.nr.3203/19. Sipas parashtruesit të ankesës, me datë 13.09.2022 pala e paditur ka dhënë përgjigje në padi sipas aktvendimit të dërguar nga gjykata, mirëpo pavarësisht kësaj gjykata nuk e ka caktuar seancën përgatitore brenda afatit prej 30 ditësh, sikurse parashihet me dispozita ligjore të LPK-së. Sipas të njëjtit, lidhur me këtë çështje i është drejtuar gjyqtares së çështjes me rreth 5 parashtresa, me kërkesë për caktim të seancës përgatitore, ose që gjykata të vendos pa caktuar fare seancë gjyqësore, sipas dispozitave të parapara me nenin 398 dhe 400 të KPK-së. Lidhur me këto parashtresa të dërguara, sipas të njëjtit nuk ka pranuar asnjë përgjigje dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesën disiplinore, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se lëndën në fjalë e ka pranuar me datë 14.10.2019, mirëpo duke marrë parasysh numrin e madh të lëndëve të cilat janë pranuar më herët se sa lënda C.nr.3203/19 me kontest vërtetim pronësie por edhe konteste tjera, ka qenë e pamundur që lënda në fjalë të shqyrtohet, duke pas parasysh se gjykata lëndët i shqyrton në bazë të parimit të vjetërsisë së lëndëve. Sipas gjyqtares, e njëjta

është duke punuar me lëndë të kontestit vërtetim pronësie nga viti 2007 e deri në vitin 2016 varësisht plotësimit të kushteve procedurale, pra ende nuk ka arritur që të shqyrtoj lëndë të vitit 2019. Mirëpo, ndër të tjera gjyqtarja e çështjes në deklaratën e saj ka njoftuar se duke marrë parasysh se padia nuk është kontestuar nga i padituri, pavarësisht se konsiderohet lëndë e re (viti 2019) do të bëjë përpjekje që të njëjtën ta caktoj dhe shqyrtoj brenda 3 mujorit të parë të vitit 2024.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares U.H.

Nuk është kontestues fakti se padia për vërtetim pronësie është paraqitur me datë 17.09.2019 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nga paditësi L.SH me përfaqësues sipas autorizimit av. SH.B, kundër të paditurës V.XH.

Nga të gjeturat rezulton se gjyqtarja e çështjes U.H është e ngarkuar me rreth 1000 lëndë, ku prej tyre 90 lëndë i takojnë vitit 2019. Prej 90 lëndëve të vitit 2019, 64 prej tyre janë të pranuarra më herët se lënda C.nr.3203/19, me konteste vërtetim pronësie por edhe konteste të natyrave tjera. Duke marrë parasysh se gjyqtarja e çështjes ka ende shumë lëndë të viteve 2006 e tutje të pa trajtuara a po në trajtim, nuk mund të lëshohet në caktimin dhe trajtimin e lëndës së vitit 2019, pasi që gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë veprojnë në bazë të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 i miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe Opinioneve të Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilët përmes planeve strategjike dhe opinioneve kanë përcaktuar kontestet të cilat duhet të trajtohen me prioritet nga gjyqtarët, ku lënda me kontest vërtetim pronësie nuk bënë pjesë në lëndët për të cilat kërkohet trajtim urgjent.

Këto plane kanë paraparë detyrimin e gjyqtarëve që të gjitha lëndët të cilat sipas ligjit dhe planeve strategjike nuk konsiderohen si lëndë për trajtim me prioritet, të caktohen dhe trajtohen në bazë të radhës së pranimit dhe regjistrimit të tyre në gjykatë.

Autoriteti Kompetent duke parë ngarkesën e gjyqtares me lëndë dhe pas vlerësimit të regjistrave të punës së gjyqtares, ka gjet se deri te zvarritja e procedimit të kësaj lënde nga gjyqtarja ka ardhur si pasojë e ngarkesës me lëndë e jo për shkak se gjyqtarja me veprimet apo mosveprimet e saj po ndikon qëllimshëm në zvarritje.

Duke marrë parasysh numrin e madh të lëndëve dhe me qëllim të shkurtimeve të kohës së pritjes, Gjykata Themelore në Prishtinë në Planin e Punës për vitin 2024 ka paraparë që për të gjitha lëndët civile të bëjë shqyrtimin paraprak të padisë. Me këtë rast, gjyqtarët janë njoftuar se në çdo rast kur vlerësohet se janë plotësuar kushtet ligjore procedurale për zgjidhje të lëndës me ndërmjetësim a po kur palët nuk kanë kundërshtim lidhur me padinë dhe kërkesëpadinë, gjyqtarët në bazë të planit të tyre të punës do të bëjnë përpjekje për caktim dhe trajtim të çështjes në një afat optimal.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/18/23, me datë 10.01.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë